



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 924/10 prot.

Tiranë, më 14.7.2025

V E N D I M

Nr. 21, datë 14.7.2025

P Ë R

**PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR GJYQATAR 2024-2025, TË CILËT
KANË KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS NGA
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 310, datë 4.6.2025, "Për kualifikimin e kandidatës znj. D R për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025" dhe vendimit nr. 374, datë 1.7.2025 "Për kualifikimin e kandidatës znj. J B G për në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 14.7.2025,

V E N D O S I:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për gjyqtar, për vitin akademik 2024-2025, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.